



PSH.nr.856/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Nuhi Paçarizi – Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “EOR GRUP” SHPK-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “NIL ARCHITECTS SH.P.K.; A & F CONSTRUCTION SH.P.K”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i Sallës së Takimeve” me nr. të prok: 633-20-4964-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Istog, më datën: 23.11.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. REFUZOHET**, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik “EOR GRUP” SHPK-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i Sallës së Takimeve” me nr. të prok: 633-20-4964-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Istog.

**II. VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i Sallës së Takimeve” me nr. të prok: 633-20-4964-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Istog.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues ekonomik "EOR GRUP" SHPK Prishtinë, refuzohet si e pabazuar, të njëjtit operator ekonomik i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "EOR GRUP" SHPK- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 26.10.2020 me nr. 856/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i Sallës së Takimeve" me nr. të prok: 633-20-4964-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Istog, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe 41.1; 41.3.1; 41.3.3, 41.5 dhe 41.6. të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 27.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 06.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Ekspertja shqyrtuese, sqaron se OE ankues në ankesën e tij ka pretendimet ankimore lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë për të cilin pretendon se AK-ja, në kundërshtim me dispozitat e LPP-së ka bërë vlerësimin e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë.

OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar deklaratë mbi pajtueshmërinë me ane xin I. Ekspertja shqyrtuese pasi ka ekzaminuar dosjen e tenderit, sqaron se nuk ekziston kjo kërkesë për të cilën pretendon OE ankues.

Po ashtu sa i përket pretendimit të OE ankues se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar deklaratë për fillimin / përfundimin e kontratës. Ekspertja shqyrtuese sqaron se sa i përket pikës 5.1 dhe 5.2 të FDT-së, sqaron se është vetëm njoftim për operatorët ekonomik dhe nuk është kërkesë për ndonjë deklaratë apo dëshmi tjetër.

Po ashtu është i paqëndrueshëm pretendimi i OE ankues se të rekomanduarit për kontratë i mungon plani dinamik, për faktin se në FDT dhe specifikacion teknik nuk ka kërkesë për plan dinamik.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar garancion 24 muaj sipas kërkesës së specifikacionit teknik. Ekspertja shqyrtues po ashtu vlerëson se nuk ka kërkesë për garancion për pajisjet e kërkuara.



Ekspertja shqyrtuese, sa u përket pretendimeve të sqaruara më lart, sqaron se në dosje të tenderit nuk ka specifikacion teknik. Të gjitha pretendimet e lartshënuara të OE ankues gjenden tek përshkrimi i çmimit të cilat nuk mund të merren si kërkesa të kualifikueshmerisë se je operatori ekonomik. Sipas dispozitave të nenit 59 të LPP-së, AK-ja do ta konsideroj si të përgjegjshëm vetëm OE i cili është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe në rastin konkret pretendimet e sqaruara më lart nuk janë në FDT dhe specifikim teknik, por tek përshkrimi i çmimit.

Ekspertja shqyrtuese vlerëson se AK-ja ka bërë vlerësimin e ofertave në përputhje me nenin 59 të LPP-së dhe njëherit sqaroj se ka rekomanduar për kontratë ofertën me çmimin më të lirë sipas kriterit kryesor për dhënie të kontratës.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Duke u bazuar në sqarimet e dhëna më lart i propozoj panelit shqyrtues që ankesën e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Autoriteti Kontraktues me datë 09.11.2020, me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues mirëpo i njëjti nuk ka kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik me datë 09.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Nuk pajtohem me mendimin e ekspertit. I lutem panelit shqyrtues, që raporti i ekspertit shqyrtues me Nr. 856/20, të hudhet poshtë dhe të mos merret për bazë nga paneli shqyrtues i OSHP-së. Pse themi të mos merret për bazë mendimi i ekspertit shqyrtues janë arsyet se pretendimet tona qendrojnë dhe po i ri argumentojmë, në vijim: Ekspertja në raportin e ekspertizës thotë: I. OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar deklaratë mbi pajtueshmërinë me aneksin 1. Ekspertja shqyrtuese pasi ka ekzaminuar dosjen e tenderit, sqaron se nuk ekziston kjo kërkesë për të cilën pretendon OE ankues. Përgjigjeja e OE në pikën I Në dosjen e tenderit të Aneksi 1 është e shënuar kështu: Dhe në e-prokurim: gjenden të bashkangjitura si dokumente shtesë, tek dosja e tenderit, me poshtë e keni të bashkangjitur print screen të e-prokurimit ku mund të shihni se përshkrimi teknik dhe projekti zbatues janë pjesë e dosjes së tenderit II. Poashtu sa i përket pretendimit të OE ankues se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar deklaratë për fillimin/perfundimin e kontratës. Ekspertja shqyrtuese sqaron se sa i përket pikës 5.1 dhe 5.2 të FTD-së, sqaron se është vetëm njoftim për operatorin ekonomik, dhe nuk është kërkesë për ndonjë deklaratë apo dëshmi tjetër. Edhe në këtë rast nuk pajtohem me mendimin e ekspertit, pasi që në qoftë se pika 5.1 dhe 5.2 qenkan vetëm deklarata dhe nuk qenkan kërkesa, atëherë sipas këtij mendimi të ekspertit s'ka qenka afat për fillimin/perfundimin e kontratës, kur nuk deklarohet OE për afatet kohore. Duke përdorur këto standard

të dyfishta më të vertet ne si OE po demtohem shumë rend gjatë prokurimit publik. III. Sa i përket pretendimit të OE ankues se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar garancion 24 muaj sipas kërkeses se specifikacionit teknik. Ekspertja shqyrtuese poashtu vleron se nuk ka kërkesë për garancion për paisjet e kerkuara. Po ashtu edhe në këtë pikë nuk pajtohem me mendimin e ekspertit, sepse siç e cekem po shfrytëzohen nga AK-të standarde të dy fishta për OE-të, dhe ekspertja nuk e ka vlersuar drejt kërër pretendimit, pasi që garancioni kërkohet të Përshkrimi i çmimeve - RREGULLIMI I SALLES SE TAKIMEVE, të bashkangjitur dhe nenvizuar kërkesën e keni me print screen nga dokumenti: Përshkrimi i çmimeve - RREGULLIMI I SALLES SE TAKIMEVE Adresa: Deshmoret e Ponoshecit Nr. 101, 10 000 Prishtinë Tel: +386 49 542 333; e-mail: eor.groupshpk@gmail.com NRU: 810872946 NRF: 601725130 TVSH: 330343070

EO GROUP SHPK eor group sh p k IMPORT - EXPORT Pse AK-ja vendosë këtë kërkesë të përshkrimi i çmimeve, dhe thotë se nuk është kërkesë po ashtu edhe ekspertja. Nga dokumenti i bashkangjitur shihet kërkesa e AK-së. Kurse në nga çësja në dokumentacion nuk kemi parë as një dokument apo deklaratë të OE të shpallur fitues se pajtohet me kërkesat e Aneksi 1 apo ka dhënë deklaratë për garancion të paisjeve në afat prej 24 muajve. Nëse nuk ka qenë kërkesë e AK-së, atëherë vijë pyetja pse AK-ja (Të këtë së paku 2 vite garancion) e ka shënuar kur ka mundur si në pjesën e parë pika 1 Punët e dyshemes dhe punët tjera dhe pika 2 Punët e Inventarit, të Përshkrimi i çmimeve - RREGULLIMI I SALLES SE TAKIMEVE të përshkruaj vetëm produktin pa kërkesën e afatit garantues, të bashkangjitur me poshtë e keni print screen, ku shihet se në pikën 1 dhe pikën 2 nuk kemi kërkesë për garancion ndërsa pika 3 me nënpikat e saj kërkohet garancioni së paku 2 vite garancion për produkte: IV. Ekspertja shqyrtuese, sa u përket pretendimeve të sqaruara më lart, sqaron se në dosje të tenderit nuk ka specifikim teknik. Të gjitha pretendimet e lartshënuara të OE ankues gjenden të përshkrimi i çmimit të cilat nuk mund të merren si kërkesa të kualifikueshme se një operator ekonomik. Sipas dispozitave të nenit 59 të LPP-së, AK-ja do ta konsideroj të përgjegjshëm vetëm OE i cili është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe në rastin konkret pretendimet e sqaruara më lart nuk janë në FDT dhe specifikim teknik, por të përshkrimi i çmimit. Edhe një herë po i ri perseriti se pretendimet tona gjenden të FTD dhe specifikimi teknik është i bashkangjitur me dosjen e tenderit si dokument shtojcë në e-prokurim, e vetmja kërkesë që gjindet të përshkrimi i çmimeve është garancioni prej 2 vite për produkte. Mirpo, në qoftë se kërkesat e dhëna të përshkrimi i çmimeve nuk na qenka kërkesë e cilat për OE janë mandatore, po del se OE mund të furnizoi çfardo paisje, pra edhe ato paisje të cilat nuk janë në përputhje me përmbajtjen e dokumentit të dhënë nga AK-ja me: Përshkrimi i çmimeve - RREGULLIMI I SALLES SE TAKIMEVE. Prandaj ky pretendim i ekspertës është jo i drejtë dhe në kundërshtim me LPP-në, e për të hedhur poshtë mendimin e ekspertës po i bashkangjes me print screen kërkesat e dhëna me FTD të dosjes së tenderit ku shihet se kërkesa për afatin e fillimit/perfundimit të kontratës është të FTD e dosjes së tenderit, ANEks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME është pjesë e dosjes së tenderit ku tregon se



specifikimet teknike I gjeni te bashkangjitura si dokumente shtesë, tek dosja e tenderit ne e-prokurim dhe projekti. Me poshtë është print screen I FTD te dosja e tenderit dhe faqja e e-prokurimit ku shihen te bashkangjitura dokumentet e cekura me lartë: Bazuar në këto fakte kemi ngritur ankesen dhe kemi thënë se është shkelur, Neni 7- Barazia në Trajtim/ JoDiskriminimi dhe Transparenca, Neni 28- Specifikimet teknike, Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve dhe RRUOPP duke mos respektuar RROUP: 41.1; 41.3.1; 41.3.3; 41.5 dhe 41.6 Po e ri përserisim dhe po e faktojmë duke u bazuar në LPP se nuk pajtohem me mendimin e ekspertit të dhënë në RAPORTIN E EKSPERTIZES SHQYRTUESE Nr. 856/20 Në rastin tone Autoriteti Kontraktues, me: Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME ka percaktuar kërkesat minimale të produkteve, dhe Operatorët Ekonomik bazuar në nenin 39 të duhet të dorzojnë specifikimet teknike te detajuara apo duhet të bashkangjesë një deklarat ku deklarohet se është në pajtushmeri me kërkesat e Aneksit 1 kur janë produkte qe nuk mundë të dorzoj specifikim teknik. Prandaj mendimi i EKSPERTIT i dhënë në RAPORTIN E EKSPERTIZES SHQYRTUESE Nr. 856/20, nuk ka dhënë mendimin konformë LPP-së, dhe për këtë arsye kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së të mos merret për bazë në vendimin përfundimtar. Bazuar në LPP dhe faktet e prezantuara me ankesë kemi kërkuar të shqyrtojmë pretendimet ankimore pasi që Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nenin 39 dhe 41 RREGULLAT dhe UDHËZUESIT OPERATIV për PROKURIM PUBLIK (RRUOPP) 41.1; 41.3.1; 41.3.3; 41.5 dhe 41.6. Bazuar në faktet e prezantuara me lartë, duke pa se raporti i ekspertit shqyrtues nuk ka dhënë vlersim të sakt, duke thënë se nuk ka kërkesa me FTD dhe nuk ka Aneks 1, kurse ne i argumentuam se ekzistojnë këto kërkesa me FTD dhe dosje te tenderit si dhe shtojca ne e-prokurim. Pra raporti i eksperti nuk është i shqyrtuar sipas gjendjes faktike dhe është i mangët me informatat bazë nga FTD dhe Aneksi 1, që gjindet në e-prokurim si document shtojcë. Raporti I ekspertës nuk është i bazuar në LPP-së dhe RREGULLAT dhe UDHËZUESIT OPERATIV për PROKURIM PUBLIK (RRUOPP), pasi që për kërkesat të cilat janë dhënë nga AK-ja, ekspertja thotë se nuk ka kërkesa të tilla, deri sa ne e argumentuam me lartë se janë kërkesa të dhëna me FTD të dosjes se tenderit. Kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së, qe raportin Nr. 856/20 i ekspertit shqyrtues të mos merret për bazë, sepse është jo i drejtë dhe i pa bazuar në LPP-në dhe RRUOPP, as në fakte dhe dokumentet të dhëna me FTD dhe dosje te tenderit si dhe Njoftimin për Kontratë. Mbesim në tërësi pranë pretendimeve ankimore të deponuara me ankesë dhe kërkojmë nga OSHP ta kthejë lëndën në ri vlersim të Autoriteti Kontraktues. OSHP të kërkojë që Autoriteti Kontraktues të veprojë konformë LPP-së dhe RRUOPP, pasi që jemi Operatori Ekonomik i përgjegjshëm me çmimin më të lire. Bazuar në faktet e prezantuara kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të na shperblej me kontrat pasi plotsojmë të gjitha kërkesat e dhëna me Njoftimin për kontratë dhe kërkesat e dhëna në DT.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e

dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "EOR GRUP "SHPK-Prishtinë, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratë mbi pajtueshmërinë me anexin I.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pasi ekzaminimit të dosjes së tenderit, nuk ekziston kjo kërkesë për të cilën pretendon OE ankues.

Po ashtu sa i përket pretendimit të OE ankues "EOR GRUP "SHPK-Prishtinë, se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar deklaratë për fillimin / përfundimin e kontratës.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sa i përket pikës 5.1 dhe 5.2 të FDT-së, është vetëm njoftim për operatorët ekonomik dhe nuk është kërkesë për ndonjë deklaratë apo dëshmi tjetër. Po ashtu, është i paqëndrueshëm pretendimi i OE ankues se të rekomanduarit për kontratë i mungon plani dinamik, për faktin se në FDT dhe specifikacion teknik nuk ka kërkesë për plan dinamik.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar garancion 24 muaj sipas kërkesës së specifikacionit teknik. Ekspertja shqyrtues po ashtu vlerëson se nuk ka kërkesë për garancion për pajisjet e kërkuara.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit nuk ka specifikacion teknik. Të gjitha pretendimet e lartshënuara të OE ankues gjenden tek përshkrimi i çmimit të cilat nuk mund të merren si kërkesa të kualifikueshmerisë se je operatori ekonomik. Sipas dispozitave të nenit 59 të LPP-së, AK-ja do ta konsideroj si të përgjegjshëm vetëm OE i cili është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe në rastin konkret pretendimet e sqaruara më lart nuk janë në FDT dhe specifikim teknik, por tek përshkrimi i çmimit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në bazë të kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së, si dhe autoriteti kontraktues në bazë të nenit 60 të LPP-së ka rekomanduar për kontratë ofertën me çmimin më të lirë sipas kriterit kryesor për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



**Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK Komuna Istog;
- 1x1 OE "EOR GRUP" SHPK Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.